



TERMAT E REFERENCES

Lloji i vlerësimit	Konsulent nacional për lehtësimin e procesit të vlerësimit të nevojave në fushën e mirëqenies sociale dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në vend si dhe rishikimin e drejtimeve strategjike dhe avokuese të organizatës SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
Vendi	Kosovë
Lloji i konsulencës	Ekspert individual
Kohëzgjatja	Shkurt-Maj 2023 (15 ditë pune)
Data e pritshme e fillimit	Shkurt 2023
I raporton	SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë

1. Hyrje

Këto terma të referencës shërbejnë si kërkesë për propozime nga ekspertët individual që janë të interesuar të lehtësojnë procesin e vlerësimit të nevojave në fushën e mirëqenies sociale dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në vend si dhe rishikimin e drejtimeve strategjike dhe avokuese të organizatës SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Internacional është organizata ombrellë e federatës botërore të 118 shoqatave kombëtare të SOS Fshatrave të Fëmijëve, që veprojnë me programet e tyre në shumë vende të botës. Ne punojmë bashkërisht me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familje dhe rritet me dashuri, respekt dhe i sigurt. Ne ofrojmë përkujdesje afatgjatë familjare, në mënyrë unike, për fëmijët dhe të rinjtë që e kanë humbur kujdesin prindëror, me familjet dhe komunitetet e cenueshme për t'u ndihmuar që të fuqizohen dhe ta parandalojnë braktisjen e fëmijëve.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare për zhvillim social, e cila është aktive në fushën e të drejtave të fëmijëve duke i mbështetur nevojat dhe shqetësimet e tyre që nga viti 1999. Ne ndërtojmë familje për fëmijë pa përkujdesje prindërore, ne u ndihmojmë atyre që ta formësojnë të ardhmen e tyre dhe marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë punon në partneritet me institucionet përgjegjëse, organet shtetërore, akterët kryesorë, organizatat kryesore dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale të fëmijëve në nevojë, dhe u krijon mundësi të rinjve që të përfshihen me kontributin dhe ndikimin e tyre në formësimin dhe hartimin e politikave dhe në zhvillimin e shërbimeve dhe programeve.



1.1 Konteksti i programit

Në kuadër të Strategjisë Nacionale të Avokimit dhe Planit të Veprimit SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, po kërkojmë një ekspert individual procesin e vlerësimit të nevojave në fushën e mbrojtjes sociale dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në vend si dhe rishikimin e drejtimeve strategjike dhe avokuese të organizatës.

1.2 Kohëzgjatja e vlerësimit

Data e synuar e fillimit të angazhimit është Shkurt 2023, ndërsa angazhimi do të përfundojë në Maj 2023, me gjithsej 15 ditë angazhimi.

2. Qëllimi i shërbimit

2.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij angazhimi është lehtësimi i procesit të vlerësimit të nevojave në fushën e mbrojtjes sociale dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në vend si dhe rishikimin e drejtimeve strategjike dhe avokuese të organizatës.

2.2. Rezultatet e pritshme:

- Analiza e gjendjes momentale në vend në fushën e mirëqenies sociale dhe të faktorëve të jashtëm kyç që ndikojnë në organizatë; përmes analizës PESTLE (përfshinë faktorët politikë, ekonomikë, social, teknologjik, ligjor dhe mjedisor)
- Analizimin e dokumenteve dhe strategjive aktuale të organizatës në rishikimin dhe përcaktimin e drejtimit strategjik për vitet në vazhdim
- Fasilitimin dhe shkrimin e raportit nga fokus grupi me akterët kyç dhe partnerët në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve sociale;
- Fasilitimin dhe shkrimin e raportit nga fokus grupi me menaxhmentin dhe Bordin e organizatës përmes analizës SWOT
- Fasilimin e punëtorisë për hartim të objektivave strategjike të organizatës
- Përcaktimi i objektivave për organizatën dhe përcaktimin e fushave kryesore që do të adresohen përmes dokumentit strategjik
- Zhvillimi i treguesve bazë dhe të synuar, përfshirë zhvillimin dhe përcaktimin e mënyrave për të matur arritjen e qëllimeve të përcaktuara si dhe përcaktimin e qëllimeve të matshme që shprehin nivelin e pritur të performancës;
- Planifikimi i aktiviteteve kryesore së bashku me afatet e tyre kohore dhe përgjegjësitë e zbatimit të krijuara për të arritur objektivat dhe për të sjellë ndryshimin e dëshiruar;
- Ndihejmon në zhvillimin e ideve programore në fushat strategjike që janë më të reja;
- Dorëzimi i draftit përfundimtar të dokumentit/ raportit

Plani i punës së bashku me metodologjinë e propozuar të cilat i ofron eksperti duhet të përshkruajnë në detaje planin e punës dhe metodologjinë (metodat dhe mjetet e punës) duke përfshirë edhe objektivat kryesore, hapat dhe procedurat se si do të realizohet angazhimi, përpilimi i të dhënave, afati kohor, etj.

3. Shkathtësitë e kërkuara (përvoja dhe kualifikimet) nga eksperti

- Kompetencë/përvojë të dëshmuar (të dhënat e përvojes paraprake) në angazhime të ngjashme;
- Nivel universitar shkollimi në shkenca sociale, ekonomi, menaxhim projektesh ose ndonjë fushë të ngjashme.
- Të ketë përvojë së paku pesë vjet përvojë në fushën e hartimit të strategjive, planeve të veprimit në nivelin qendror apo lokal, përvojë të punës në fushën e mbrojtjes sociale, punës ose dialogut social;
- Të ketë përvojë në udhëheqje, ndërtim kapacitetesh dhe trajnime në fushën përkatëse;
- Të ketë shkathtësi të shkëlqyeshme në shkrim dhe komunikim;
- Duhet të ketë njohuri të mira për sistemin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve;
- Të ketë njohuri të mira për sistemin e shërbimeve sociale dhe familjare si dhe njohuri mbi kontekstin socio-politik;
- Të ketë përvojë dhe punë të dëshmuar me institucione nga sektori shoqëror dhe organizata që ofrojnë shërbime sociale;
- Duhet të ketë përvojë e dëshmuar e bashkëpunimit efektiv me institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal, ofruesit e shërbimeve publike dhe OJQ-të;
- Duhet të ketë shkathtësi të mira personale dhe ndër-personale për punë në ekip;
- Duhet të garantojë dorëzimin me kohë të rezultateve dhe detyrave të pritshme;
- Duhet të jetë i njoftuar me standardet etike lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët dhe do t'u kërkohet që ta nënshkruajnë dhe t'i përmbahen Politikave për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze është e detyrueshme, gjuha serbe është përparësi;

4. Periudha kohore

Angazhimi do të realizohet nga muaji Shkurt deri në Maj 2023.

5. Produktet që duhet të dorëzohen në fund të angazhimit:

- Draft-Raporti me vlerësimin e gjendjes dhe propozimet për drejtimet strategjike të Organizatës 07 Prill 2023.
- Raporti final me propozimet për drejtimet strategjike të Organizatës duhet të dorëzohet deri më 15 Maj 2023.

6. Aneksi – Politikat e SOS Fshatrave të Fëmijëve

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë e ka dokumentin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodin e sjelljes, të cilat eksperti pritet t'i përmbahet dhe nga ta do të kërkohet ta nënshkruajnë një deklaratën e përkushtimit ndaj Politikave të SOS Fshatrave të Fëmijëve të cilat përfshijnë: Politikës për mbrojtjen e fëmijëve, Rregullorja për Parandalimin dhe mbrojtjen kundër ngacmimit, shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, Kodin e mirësjelljes si dhe Deklarata për ruajtjen e të dhënave të zotimit ndaj këtyre politikave. Kjo do të bëhet me rastin e nënshkrimit të kontratës, ku konsulenti do të udhëzohet lidhur me proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve dhe rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave.

7. Udhëzime për ofertuesit (procesi i dorëzimit të ofertave)

I ftojme ofertuesit që t'i dorëzojnë propozimet e tyre për angazhimin dhe lehtësimin e procesit të vlerësimit të nevojave në fushën e mbrojtjes sociale dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në vend si dhe rishikimin e drejtimeve strategjike dhe avokuese të organizatës.

Në formatin PDF dhe t'i dërgojnë në mënyrë elektronike në info@soskosova.org

Oferta është e hapur për të gjithë ekspertët e pavarur që mund t'i ofrojnë shërbimet e kërkuara. Propozimi dhe të gjitha dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe. Oferta financiare duhet të shprehet në Euro.

Dokumentet që duhet dorëzuar:

- CV e ekspertit
 - Propozimi teknik dhe metodologjia për kryerjen e shërbimit të kërkuar
 - Kopje e letër-njoftimit
 - Tri letër referenca
- Propozimi financiar- çmimi duhet të konsiderohet pagesë BRUTO (Oferta duhet të jetë e vlefshme për dy javë).

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova:

- vërtetim që nuk është nën hetime

8. Kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet e pagesës

- Pagesa do të bëhet vetëm pasi SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ta pranojë punën e realizuar sipas produkteve të përshkruara më lartë. Pagesa do të bëhet nëpërmjet transferit bankar në llogarinë bankare të ekspertit individual duke ndalur tatimin në të ardhura personale dhe



kontributin pensional, sipas ligjit në fuqi dhe jo me vonë se 30 ditë pas pranimit të punës së realizuar

- Paguesa për ekspertin do të bëhet me këste, si në vijim:
 - 50% me rastin e përfundimit të draftit të parë për vlerësimin e gjendjes dhe propozimet për drejtimet strategjike të Organizatës
 - 50% me rastin e përfundimit dhe aprovimit të propozimeve për drejtimeve strategjike të Organizatës dhe dorëzimit të produkteve të punës sipas pikës 5.

Kriteret e përzgjedhjes:

Kriteret	Maksimumi i pikëve
• Përvoja e ekspertit në procese të këtilla angazhimi (të bashkëngjitet CV). vlerësimi behet në bazë të kualifikimeve dhe përvojës	30
• Metoda (metodologjia) e propozuar për realizimin e shërbimit është e përshtatshme, ndërsa plani i punës është real dhe e përmbush qëllimin.	40
• Çmimi i ofertës financiare	30
Totali	100

Afati për dorëzim:

Aplikacioni duhet të dërgohet më së voni më 09.02.2023 deri në mesnatë. Aplikacionet që dërgohen pas këtij afati nuk do të merren parasysh.